

VENDIM
Nr. 147, datë 31.3.2000

**PËR RREGULLAT DHE MËNYRËN E FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË POSAÇËM
PËR SHPRONËSIMET**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe nenit 11 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Komisioni i posaçëm për shpronësimet, krijohet me urdhër të ministrit dhe ushtron veprimtarinë që nga çasti i krijimit të tij deri në përfundim të procesit të dhënies a vënies në dispozicion të shpërblimit të shpronësimit në favor të të shpronësuarit.

2. Mbledhjet e komisionit të posaçëm për shpronësimet thirren dhe drejtohen nga kryetari.

3. Përcaktimi i rendit dhe i datës së zhvillimit të mbledhjes së komisionit vendoset nga kryetari i komisionit, i cili kujdeset për shpërndarjen e materialit, si rregull të paktën tre ditë përpara asaj të caktuar për mbledhjen e tij.

4. Komisioni i posaçëm për shpronësimet mbledhet sa herë të jetë e nevojshme.

5. Mbledhjet e komisionit të posaçëm për shpronësimet janë të vlefshme kur janë të pranishëm jo më pak se 3/4 e anëtarëve të tij.

6. Në fillim të mbledhjes, kryetari i komisionit verifikon numrin e pjesëmarrësve dhe në mungesë të shumicës së nevojshme, vendos thirrjen e mbledhjes tjetër jo më vonë se dy ditë.

7. Në rastet e mospjesëmarrjes pa arsye të motivuar, krahas largimit nga komisioni, ndaj anëtarit të komisionit të posaçëm për shpronësimet, titullari përkatës jep masë disiplinore sipas ligjit nr.8549, datë 11.11.1999, "Për statusin e nëpunësit civil".

8. Sipas vlerësimit të kryetarit të komisionit, në mbledhjet e komisionit të posaçëm për shpronësimet thirren dhe janë të detyruar të marrin pjesë për shpjegime dhe sqarime të posaçme specialistët përkatës. Këta persona nuk kanë të drejtë vote.

9. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve sipas rendit të ditës, kryetari i komisionit të posaçëm të shpronësimit vendos hedhjen në votë të çështjeve për të cilët duhet të merren vendim nga komisioni.

10. Vendimet e komisionit të posaçëm për shpronësimet merren me shumicën e votave (shumicë absolute) të anëtarëve me të drejtë vote. Në rast barazie votash, vendos vota e kryetarit të komisionit.

11. Vendimet e komisionit të posaçëm për shpronësimet janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjitha strukturat dhe personat e ngarkuar posaçërisht nga përmbajtja e tij.

12. Vendimet e marra nga komisioni i posaçëm për shpronësimet i dërgohen menjëherë ministrit, i cili brenda 10 ditëve, për shkaqe ligjore dhe arsye të motivuara ka të drejtë të kërkojë rishqyrtimin e çështjes nga komisioni.

13. Në ushtrimin e funksioneve të tij, komisioni i posaçëm për shpronësimet, ndihmohet nga një sekretari teknike. Kjo sekretari me aktin e krijimit të komisionit nga ministri, caktohet dhe operon në një nga strukturat e ministrisë.

14. Sekretaria teknike ka për detyrë të kujdeset për shkëmbimin e informacionit, dërgimin e njoftimeve dhe përgatitjen e materialeve që shqyrtohen në mbledhjen e komisionit të posaçëm për shpronësimet si dhe të procesverbaleve të mbledhjes.

15. Sekretaria teknike kujdeset dhe përgjigjet për dërgimin dhe marrjen e të dhënave, të njoftimeve dhe të korrespondencës me organet, personat juridikë dhe fizikë lidhur me procedurën e shpronësimit.

16. Çështjet dhe procedurat që shqyrtohen nga komisioni i posaçëm për shpronësimet janë ato që parashikohen në ligjin nr.8561, datë 25.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", dhe vendimit nr.126, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave, "Për përbërjen dhe procedurat e punës së komisionit të posaçëm të shpronësimit", të dalë në bazë dhe për zbatim të tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta